



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 20.05. 2020

NJOFTIM PUNËSIMI

Bazuar në Projekt Vendimin Nr. 215, datë 12.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshimenë Vendimin nr. 47, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2020 në njësitë e qeverisjes qendrore””, AZHBR shpall njoftimin e punësimit si mëposhtë:

- **NËPUNËS INFORMACIONI NË AZHBR QENDËR** (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria III
- **Detyrat kryesore:** Ofron shërbim në recepsion dhe/ose në media sociale, numrin jeshil duke respektuar rregullat e etikes dhe komunikimit me qytetarët / fermerët. Informon dhe promovon programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

- Të kenë mbaruar arsimin e lartë universitar, niveli Bachelor. (Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi).
- Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
- Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
- Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
- Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesionale

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. - Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Shqipërinë në kuadër

të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD).

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural", i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 27.05.2020, ora 13.00 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.

TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR www.azhbr.gov.al, PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR www.azhbr.gov.al.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL